



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
V E N D I M
K.P.P.798/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.12.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Avduli” shpk & “Bahas” shpk nga procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-29669-10-13-2017 me objekt: “Rikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinave së rikuperove pranë parkut të naftës”, me fond limit 21,792,283 lekë pa tvsh, i parashikuar për t’u zhvilluar në datën 07.11.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kuçovë.

Ankimues: BO “Avduli” shpk & “Bahas” shpk
Lagjia 10 Korriku, Rruga Perlat Rexhepi, objekt 3 katësh nr.4,
Kati I Vlorë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kuçovë
Rruga “Nënë Tereza”, Kuçovë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. Bashkimi i operatorëve “Avduli” shpk & “Bahas” shpk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Avduli” shpk & “Bahas” shpk.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.10.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-29669-10-13-2017 me objekt: “Rikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinave së rikuperove pranë parkut të naftës”, me fond limit 21,792,283 lekë pa tvsh, i parashikuar për t’u zhvilluar në datën 07.11.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kuçovë.

II.2. Në datën 07.11.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 17.11.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

Shendelli	pa ofertë	I skualifikuar
Fled	pa ofertë	I skualifikuar
Kola Invest	pa ofertë	I skualifikuar

Jogi	pa ofertë	I skualifikuar
B93	pa ofertë	I skualifikuar
Spektri	pa ofertë	I skualifikuar
Avduli	15,920,225	I skualifikuar
Elira	15,994,763	I skualifikuar
Pienvi	17,293,550	kualifikuar
Shkelqimi 07	18,088,010	kualifikuar
Boshnjaku B	18,958,850	kualifikuar

II.4. Në datën 17.11.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Avduli” shpk & “Bahas” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

1. Mungojnë në listpagesa inxhinierët e nevojshëm që janë drejtues teknik. Ofertuesi Avduli nuk ka në listpagesa inxhinierët Gëzim Salja ing Markshajder dhe Klodian Dhaskalin inxhinier elektrik.

II.5. Në datën 21.11.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Avduli” shpk & “Bahas” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- Referuar pretendimeve të ngritura nga ana e Komisionit të Vlersimit të Ofertave, ju sqarojmë se janë pretendime të cilat nuk kanë asnjë bazë ligjore dhe konkretisht: Në dokumentat standarte të tenderit në pikën 5 është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe drejtues teknik inxhinierët si më poshtë:

- 1- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- 2- Inxhinier Topograf 1 (një)
- 3- Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- 4- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- 5- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- 6- Inxhinier Gjeolog 1 (një)
- 7- Inxhinier Elektrik 1 (një)

Për këtë duhet të paraqesë kontratë pune të vlefshme dhe të figurojë në listëpagesa. Referuar këtij kriteri shoqëria “Avduli” shpk ka paraqitur të gjithë inxhinierët e kërkuar të cilët figurojnë në listpagesat e shoqërisë tonë që në momentin që janë punësuar pranë subjektit tonë sipas dispozitave ligjore në fuqi. Konkretisht në këtë procedurë prokurimi janë paraqitur inxhinierët si më poshtë:

Inxhinier Ndërtimi A. R me të gjithë dokumentacionin e kërkuar, kontratë pune, diplomë, CV dhe librezë pune, i cili figuron i siguruar pranë subjektit tonë që në momentin që është punësuar pranë subjektit tonë.

Inxhinier Mjedisi E. B me të gjithë dokumentacionin e kërkuar, kontratë pune, diplomë, CV dhe librezë pune, i cili figuron i siguruar pranë subjektit Avduli shpk që në momentin që është punësuar pranë shoqërisë tonë.

Inxhinier Hidroteknik E. B me të gjithë dokumentacionin e kërkuar, kontratë pune, diplomë, CV dhe librezë pune, i cili figuron i siguruar pranë subjektit Avduli shpk që në momentin që është punësuar pranë shoqërisë tonë.

Inxhinier Gjeolog L. Th me të gjithë dokumentacionin e kërkuar, kontratë pune, diplomë, CV dhe librezë pune, i cili figuron i siguruar pranë subjektit tonë që në momentin që është punësuar pranë subjektit tonë.

Inxhinier Mekanik H. J me të gjithë dokumentacionin e kërkuar, kontratë pune, diplomë, CV dhe librezë pune, i cili figuron i siguruar pranë subjektit tonë që në momentin që është punësuar pranë subjektit tonë.

Të gjithë inxhinierët e mësipërm referuar listpagesave të shoqërisë Avduli shpk janë të siguruar dhe vazhdojnë të jenë të siguruar edhe sot pranë subjektit tonë. Përsa i përket inxhinierit elektrik **K. Dh** dhe inxhinierit topograf **G. S** janë të siguruar pranë shoqërisë tonë në momentin që është zhvilluar kjo procedurë prokurimi dhe figurojnë drejtues teknik në liçensën e shoqërisë tonë pasi janë ata janë punësuar më vonë se periudha që ju kërkon listpagesat. Pra autoriteti kontraktor ka kërkuar listpagesat nga Janari 2017 deri në Prill 2017. Inxhinieri elektrik **K. Dh** dhe inxhinieri topograf **G. S** janë punësuar pranë shoqërisë tonë në muajin Maj (inxhinieri elektrik **K. Dh**) dhe në muajin Gusht (inxhinieri topograf **G. S**) e për pasojë nuk ka se si të jenë të siguruar pranë shoqërisë tonë për periudhën Janar – Prill 2017, pasi në atë moment nuk kanë qenë të punësuar pranë subjektit Avduli. Për periudhën që Autoriteti Kontraktor ka kërkuar listpagesat shoqëria Avduli ka pasur të punësuar Inxhinier Elektrik **F. B** dhe Inxhinier Topograf/Markshajder Inxhinier **Q. L** të cilët në momentin që është zhvilluar kjo procedurë prokurimi nuk janë më të punësuar pranë shoqërisë tonë dhe në nuk mund të paraqesim në këtë procedurë prokurimi inxhinier të cilët nuk punojnë më pranë subjektit tonë. Pra subjekti jonë ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi listpagesat për periudhën Janar 2017-Shtator 2017 fakt i cili konfirmon se kemi pasur të punësuar inxhinierin elektrik **F. B** për periudhën Janar 2017 – Prill 2017, periudhë e cila ju kërkon listpagesat dhe inxhinier markshajder/topograf **Q. L**. Më vonë kemi punësuar inxhinierët e tjerë dhe i kemi siguruar pranë subjektit tonë sipas dispozitave ligjore në fuqi. Për sa më sipër pretendimet e ngritura nga ana e Komisionit të Vlersimit të Ofertave nuk qëndrojnë. Pretendimi juaj nuk qëndron edhe për faktin se në këtë procedurë prokurimi ofertues nuk ka qenë vetëm subjekti Avduli shpk, por kemi marrë pjesë në bashkëpunim me subjektin Bahas shpk e për pasojë kriteri 5 në dokumentat standarte të tenderit plotësohet nga bashkimi i operatorëve ekonomik Avduli & Bahas shpk, pasi në këtë procedurë prokurimi është paraqitur për subjektin Bahas shpk bashkë me të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana juaj Inxhinieri Elektrik **F. M** dhe Inxhinieri Markshajder/Topograf **M. D** të cilët figurojnë drejtues teknik në Licensën e shoqërisë Bahas shpk dhe të siguruar për periudhën e kërkuar nga ana juaj. Referuar ligjit “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 74 (Bashkimi i operatorëve ekonomik) rezulton se kërkesat për kualifikim në këtë procedurë prokurimi janë përmbushur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Avduli & Bahas” shpk e për pasojë pretendimet e ngritura nga ana e KVO-së nuk qëndrojnë, pasi në rast bashkimi të operatorëve ekonomik duhet të vlerësohen dokumentat e paraqitura nga i gjithë bashkimi i operatorëve ekonomik.

Pra sa më sipër kërkojmë anullimin e vendimit të KVO-së dhe kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik “Avduli & Bahas” shpk, pasi vendimi i KVO-së është i padrejtë dhe i pabazuar në prova dhe në ligj.

II.6. Në datën 01.12.2017 me shkresën nr. 3734/1 prot, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Avduli” sh.p.k., & “Bahas” shpk është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor si dhe janë shtuar arsye të reja skualifikimi si më poshtë:

“Opertori ekonomik duhet të disponoj Fabrik Betoni 1 copë , e cila duhet të jetë në pronësi, qera ose me kontratë furnizimi. Kjo fabrikë betoni duhet të ketë leje mjedisore të tipit B, kodi III 1.B dhe monitorimin mjedisor të 6 mujorit të fundit”.

Në rastin konkret të dy operatorët ekonomik “Avduli” shpk dhe “Bahas” shpk, kanë paraqitur:

- *Operatori ekonomik “Avduli” shpk Kontratë Furnizimi noteriale me Nr. 1619 Rep dhe Nr. 1245 Kol, datë 23.02.2017 të nënshkruar me shoqërinë “Beton Vlora” shpk për furnizim me beton, ku sipas QKL-së paraqitur kjo fabrikë Betoni është e kodit III. A dhe jo të kodit III. 1.B sipas kriterit të vendosur në DST.*
- *Operatori ekonomik “Bahas” shpk ka paraqitur Kontratë Furnizimi noteriale Nr. 1619 Rep, dhe Nr. 1245 Kol, datë 23.02.2017 të nënshkruar me shoqërinë “Sina 98” shpk për furnizim me beton, ku duket qartë se sipas dokumentave që ju keni në sistem si psh QKL-ja e shoqërisë “Sina 98” shpk, nuk figuron aspak fabrikë betoni edhe në rastin nëse ky fakt merrej i mirqenë nga KVO kjo fabrikë betoni vërtetohet qartë se ka kodin III.1.A dhe jo III.1.B si edhe kërkohet në kriterin e vendosur në DST.*
- *“Avduli” shpk ka paraqitur gjithashtu edhe një Kontratë Qeraje me Nr. 290 Rep dhe Nr. 612 Kol, datë 15.12.2014 e nënshkruar midis “Jody Company” shpk, në të cilën vërehet qartë nga objekti i kësaj kontrate dhe vërtetimi i administratës doganore Sarandë datë 11.02.2010 se kjo linjë është për prodhim asfalto betoni për rrugët dhe jo fabrikë betoni si kërkohet në kriteret e vendosura në DST.*
- *Monitorimi i 6 mujorit të fundit për fabrikat e betonit mungon në të gjitha rastet e sipërcituara.*

II.7. Në datën 06.12.2017, pala ankimuese “Avduli” sh.p.k.,& “Bahas” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik më të njëtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor si dhe duke kundështuar arsyet e reja të skualifikimit në kthim përgjigjen drejtuar ankimuesit.

II.12. Nëpërmjet shkresës me nr. 3901/1 prot datë 12.12.2017 protokolluar me tonën me nr.1795/2 datë 14.12.2017 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Avduli” shpk & “Bahas” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se “Mungojnë në listpagesa inxhinierët e nevojshëm që janë drejtues teknik. Ofertuesi Avduli nuk ka në listpagesa inxhinierët Gëzim Salja ing Markshajder dhe Klodian Dhaskalin inxhinier elektrik.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 5 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Të ketë të punësuar dhe drejtues teknik si më poshtë

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Topograf 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1(një)
- Inxhinier Elektrik 1(një)
- Inxhinier Gjeolog 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1(një)

Për këtë duhet të paraqesë kontratë pune të vlefshme. Dhe të figurojë në listepagesa. .

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomikë “Avduli” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Licencë e shoqërisë “Avduli” sh.p.k., me nr. NZ. 1916/29, ku evidentohet se ndërmjet të tjerëve janë drejtues teknik edhe punonjësit G.Z me profesion inxhinier topograf/markshajder dhe K.DH me profesion inxhinier elektrik;
- Kontratë Pune Nr.1295 Rep, Nr.408 Kol datë 17.05.2017 lidhur ndërmjet inxhinierit elektrik K.DH në cilësin e punëmarrësit dhe shoqërisë “Avduli” shpk në cilësin e punëdhënsit.
- Kontratë Pune Nr.1840 Rep, Nr.1282/2 Kol datë 03.08.2015 lidhur ndërmjet inxhinierit topograf/markshajder G.S në cilësin e punëmarrësit dhe shoqërisë “Avduli” shpk në cilësin e punëdhënsit.
- Diploma, CV, librezë e punës; të punonjësve K.Dh dhe G.S;
- Listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën Janar – Shtator 2017.

III.1.3. Në nenin 46, të LPP-së parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me

natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. a) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.1.4. Në nenin 53, pika 3 të LPP-së parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.5. Në nenin 26, pika 8, gërma (b) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.1.6. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 11.06.2009 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, neni 5 e 6 përcaktojnë përkatësisht: “5. Nomenklatura e profesioneve përbëhet nga:

- a) emërtimi i profesionit;
- b) kodi numerik i profesionit;
- c) përshkrimi i profesionit.

6. Kodi numerik i profesionit është një bashkësi me 6 shifra, të cilat tregojnë, përkatësisht,:

- a) Shifra e parë "Grupin e profesionit";
- b) Shifra e dytë "Nëngrupin e profesionit";
- c) Shifrat e tretë dhe e katërt, së bashku, "Profesionin";
- ç) Shifrat e pestë dhe e gjashtë, së bashku, "Punësimin".

Gjithashtu në këtë VKM është përcaktuar Lista Kombëtare e Profesioneve, ku secilit profesion i korrespondon një kod i caktuar i veçantë dhe ndërmjet të tjerave është përcaktuar edhe kodi 2142.01, kod i cili i korrespondon profesionit të inxhinierit elektrik dhe kodi 2114.01 kod i cili i korrespondon profesionit të inxhinierit gjeodet

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit

dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues konstatohet se punonjësi K.DH me pozicionin ing. Elektrik (për të cilën është paraqitur kontratë pune, CV, diplomë, librezë pune si dhe rezulton si drejtues teknik në licencën e shoqërisë “Avduli” sh.p.k.), është në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2017 – Shtator 2017, me profesion inxhinier elektrik (kodi 2142.01).

III.1.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues konstatohet se punonjësi G.S me pozicionin ing. topograf/markshajder (për të cilën është paraqitur kontratë pune, CV, diplomë, librezë pune si dhe rezulton si drejtues teknik në licencën e shoqërisë “Avduli” sh.p.k.), është në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Gusht 2017 – Shtator 2017, me profesion inxhinier elektrik (kodi 2114.01).

III.1.10. Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se për periudhën Janar – Prill 2017 ka pasur të punësuar një inxhinier elektrik dhe inxhinier topograf tjetër dhe konkretisht z. F.B inxhinier elektrik., dhe z. Q.L inxhinier topograf/markshajder., KPP konstaton se nga verifikimi i listëpagesave të paraqitura në periudhën Janar – Prill 2017, ka qenë i punësuar z. F.B., inxhinier elektrik me kodin 2142.01, dhe z. Q.L inxhinier topograf/markshajder referuar kolonës me emërtim *Detyra, Funksioni, Profesioni apo Puna që ka kryer punonjësi*.

III.1.11. Nga listëpagesat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues rezulton se z. F.B. ka mbajtur në këtë shoqëri profesionin e inxhinierit elektrik, e përcaktuar kjo me kodin përkatës 2142.01 në listëpagesë, i konvertuar në profesion sipas VKM nr. 627, datë 11.06.2009, është inxhinier elektrik, profesion që referuar kodit e ka kryer për periudhën Janar – Qershor 2017, dhe është zëvendësuar me z. K.DH nga periudha Korrik 2017 e në vazhdim (i cili ka të njëjtin kod 2142.01 me z. F.B.). Po kështu nga listëpagesat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues rezulton se z. Q.L. ka mbajtur në këtë shoqëri profesionin e inxhinierit gjeodet/topograf/markshajder, e përcaktuar kjo me kodin përkatës 2114.01 në listëpagesë, i konvertuar në profesion sipas VKM nr. 627, datë 11.06.2009, është gjeodet/topograf/markshajder, profesion që referuar kodit e ka kryer për periudhën Janar – Korrik 2017, dhe është zëvendësuar me z. G.S nga periudha Gusht 2017 e në vazhdim (i cili ka të njëjtin kod 2114.01 me z. F.B.) Pra, sa më sipër analizuar rezulton se shoqëria “Avduli” sh.p.k. për gjithë periudhën kohore të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ka pasur të punësuar pranë saj punonjës me profesion inxhinier elektrik, dhe inxhinier gjeodet/topograf pavarësisht se për muajt Janar – Prill 2017 nuk e ka vërtetuar këtë fakt me kontratë pune, CV, e diplomë, pasi këta punonjës nuk janë më pjesë e shoqërisë dhe ky dokumentacion është i pamundur për t’u paraqitur, por që referuar listëpagesave vërtetohet më së miri që kjo shoqëri ka pasur të punësuar në strukturat e saj një punonjës me profesion inxhinier elektrik, dhe një punonjës me profesion inxhinier gjeodet/topograf aq më tepër kur me dokumentacion është vërtetuar për një periudhë më të vonshme (Korrik – Shtator 2017) që është më e afërt me datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke treguar dhe vërtetuar zotërimin e kapacitetit për inxhinierin elektrik dhe inxhinierin gjeodet/topograf. Akoma më tej, përveç pamundësisë për të paraqitur dokumentacion për këta punonjës që nuk janë më

pjesë e shoqërisë, edhe sikur të ishte paraqitur dokumentacioni për këta punonjës, nuk do të ishte e mundur që të ishin fizikisht pjesë e stafit të kësaj shoqërie për të ndjekur punimet në rastin hipotetik të shpalljes fituese të shoqërisë “Avduli” sh.p.k. KPP gjykon se nuk mund të penalizohet një operator ekonomik vetëm për faktin se gjatë një periudhe të caktuar në stafin e tij ka pasur lëvizje dhe konkretisht lëvizje në lidhje me punonjës inxhinier elektrik dhe inxhinier gjeodet/topograf (është larguar një punonjës dhe është punësuar një tjetër), si edhe një gjë e tillë nuk mund të ndalohet, ndërkohë që e rëndësishme është të vërtetohet se kjo shoqëri ka pasur gjatë kësaj periudhe një inxhinier elektrik, dhe një inxhinier gjeodet/topograf duke treguar kapacitetet e kësaj të fundit në lidhje me stafin.

III.1.12. Nisur nga sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se sipas dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues vërtetohet fakti që në shoqërinë e tij për gjithë periudhën e kërkuar në dokumentat e tenderit Janar – Prill 2017 ka pasur të punësuar një inxhinier elektrik, dhe një inxhinier gjeodet/topograf kjo e vërtetuar nëpërmjet listëpagesave.

III.1.13. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues përmban të gjithë informacionin dhe elementët e nevojshëm në përmbushje të kërkesës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me stafin.

III.1.14. Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se autoriteti kontraktor duhet të jetë i saktë gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura dhe vlerësimin nuk duhet ta bëjë mbi baza sipërfaqësore por në funksion të mirëpërdorimit të fondeve publike.

Për autoritetin kontraktor e rëndësishme është të vërtetojë se një operator ekonomik dëshmon se ka në shoqërinë e tij një punonjës me profesion inxhinier elektrik dhe inxhinier gjeodet/topograf për një periudhë të caktuar siç është kërkuar në dokumentat e tenderit, gjë që në rastin konkret është vërtetuar nga operatori ekonomik ankimues nëpërmjet listëpagesave përkatëse si më sipër arsyetuar.

Autoriteti kontraktor në rast se do të kishte dyshime apo do të ishte i paqartë gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, mund të kishte kërkuar sqarime të mtejshme nga operatori ekonomik ankimues, bazuar kjo në legjislacionin për prokurimit publik.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Avduli” sh.p.k. është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi kërkesa për inxhinierin elektrik dhe inxhinier gjeodet/topograf plotësohet prej këtij të fundit.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik “Avduli” sh.p.k. qëndron.

III.2. Lidhur me arsyet e reja të skualifikimit të pakomunikuara më parë bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Avduli” shpk& “Bahas” shpk njoftuar me shkresën kthim përgjigje nr.3734/1 prot datë 01.12.2017, nga KSHA, si dhe me informacionin shtesë të

autoritetit kontraktor me shkresën Nr.3901/1 prot datë 12.12.2017 protokolluar me tonën me nr.1795/2 datë 14.12.2017 “Kthim përgjigje”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në nenin 54 pika 3 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”*. Në nenin 66 pika 3 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se *“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.”* Ndërkohë në nenin 67 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla”*. Në nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* *“Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëlqen e pretenduar, sipas këtij ligji.”* *“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”*. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”*

Në kreun X *“Shqyrtimi i Ankesave”*, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se *“Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:*
a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përgjithësisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *[...]Në përfundim të shqyrtimit të ankesës,*

komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 9 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim interpretim sistematik (domethënjën e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A (Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitetin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Komisioni gjykon se arsyet e reja të pakomunikuara ankimuesit brenda afateve procedurale nuk mund të sjellin asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka pasur të gjithë kohën e nevojshme dhe të mjaftueshme për të evidentuar të gjitha shkaqet skualifikuese të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në momentin e vlerësimit të ofertave. Cdo arsye tjetër e komunikuar ankimuesit jashtë të gjitha afateve ligjore, pas momentit të vlerësimit përfundimtar të ofertave nuk mund të sjellë asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik. Në rastin konkret, KPP konstaton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës ka shtuar arsye të reja skualifikimi në tejkalim të kompetencave që parashikon ligji.

III.2.3. Sa më sipër Komisioni gjykon se arsyet e reja të skualifikimit dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në tejkalim të kompetencave që u jep shprehimisht neni 78 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 nuk sjellin asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik ankimues e si të tilla nuk merren në shqyrtim nga KPP.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për

miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues *“Avduli” shpk & “Bahas” shpk* për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”* me Nr. REF-29669-10-13-2017 me objekt: *“Rikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinave së rikuperove pranë parkut të naftës”*, me fond limit 21,792,283 lekë pa tvsh, i parashikuar për t’u zhvilluar në datën 07.11.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kuçovë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues *“Avduli” shpk & “Bahas” shpk* dhe të korigjojë shkeljet duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues *“Avduli” shpk & “Bahas” shpk*.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1795 Protokolli; Datë 06.12.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha